



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr.428/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Hazhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Savez Kosovskih Srba (SKS), dega në Graçanicë, paraqitur kundër subjektit politik G.I.Srpska, dega në Graçanicë, për shkak të blerjes së votave, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.11.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Savez Kosovskih Srba (SKS) dega në Graçanicë.

**Arsyetim**

PZAP-i, me datën 02.11.2013 ka pranuar ankesë nga subjekti politik SKS, në të cilën theksohet se me datën 02.11.2013, në Graçanicë është bërë blerja e votuesve nga ana e funksionareve të lartë të G.I.Srpska, ashtu që i është dhënë mielli i votuesve potencialë për votat e tyre për zgjedhjet e nesërme. Parashtruesi i ankesës mendon se është shkelur rëndë procesi zgjedhore dhe rregullat zgjedhore. Ankesës parashtruesi i ka bashkangjitur një CD me inqizim të shkeljes.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet e ankuesit në ankesën e tij se subjekti politik G.I. Srpska, ka bërë blerjen e votave, nga funksionarët e lartë të këtij subjekti, duke ju dhënë miell votuesve potencial për Zgjedhjet Lokale të 3 Nëntorit 2013, PZAP-i, i vlerëson si të pabazuara dhe të pa argumentuara nga shkakun se nga CD-ja e ofruar si dëshmi e cila gjendet në shkresat e lëndës, nuk vërtetohet fakti ashtu siç pretendohet në ankesë, pasi që për asnjë moment nuk mund identifikohen se një veprim i tillë si shpërndarja e miellit, për qëllime të blerjes së votave, të shkojë në destinacionin e lartpërmendur siç janë votuesit potencialë, prandaj një pretendim i tillë i ankesës është i pa argumentuar në prova dhe dëshmi bindëse, dhe se një ankesë e tillë nuk mund të konsiderohet si e bazuar, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë**

Anr. 428/2013 më datën 04.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Nehat Idrizi**



***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*